



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1231_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1970_07_19**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **23.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë **12.02.2020**, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit I. K. nga Komuna e Fushë Kosovës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 23.01.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori I.K. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se në banesën për të cilën është lëshuar vendimi banon vetëm në sezonën e dimrit, dhe se për vitin për të cilën është bërë ankesa për tre muaj nuk ka banuar. Konsumatori ka theksuar se të merret parasysh ankesa dhe nuk ka mundësi të paguaj pasi është pensioner. Konsumatorit në ankesë ka theksuar se kërkon nga Bordi t'ia shkarkojnë borxhin prej 200 €, pasi ai nuk e ka bërë këtë shpenzim dhe këtë ka mundur të bëjë ndonjë kojshi e jo ai.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se kundërshton vendimin e DMK të ZRRE banon vetëm në sezonën e dimrit, Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkalës së parë është plotësisht i saktë dhe i bazuar në dispozita ligjore të legjislacionit primar të sektorit të energjisë dhe në dispozita të legjislacionit sekondar. Për më tepër Bordi i ZRRE thekson se bazuar në ankesën e konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 20.05.2017 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.1402052290 prej TL=3386 kWh dhe TU=2039 kWh dhe se gjatë analizës së bërë k[tyre shkresave konstaton se bazuar në shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit të KEDS-it vërtetohet se shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në programin e faturimit "CCP" (ang. Customer Care Package) për periudhën prill 2017 përputhen me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e inspektimit, respektivisht gjendjen në njehsorin elektrik.



Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike, procesverbalit të inspektimit nr.2157783 të datës 20.05.2017, si dhe listave të leximit për periudhën 10/2016 deri në periudhën 03/2017 konstaton se fatura nr.12160DPR-9011299 e datës 26.12.2016, si dhe 01170DPR-9011299 e datës 24.01.2017, paraqesin faturim real mujor te konsumatorit

Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Bordi i ZRRE ka bërë edhe krahasimin e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën kontestuese me periudhat e më hershme dhe të më vonshme dhe vërteton se konsumatori ka luhatje në shpenzimin e energjisë elektrike. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më vonshme të njëjta me njehsorin elektrik nr.1402052290 janë: për periudhën 12/2017 është 910 kWh, si dhe për periudhën 01/2018 është 1,048 kWh. Bordi i ZRRE-së konstaton se gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike ka vërejtur se konsumatori nga periudha mars 2017 e deri në periudhën nëntor 2017 nuk ka shpenzim të energjisë elektrike, pastaj nga periudha maj 2018 deri në periudhën dhjetor 2018 prapë nuk ka shpenzim, me çka edhe vërtetohet se konsumatori vetëm gjatë periudhës së dimrit ka shpenzime të energjisë elektrike.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se ai nuk e ka bërë këtë shpenzim dhe këtë ka mundur të bëjë ndonjë kojsi, Bordi i ZRRE thekson se ka shqyrtuar me kujdes procesverbalin e inspektimit të KEDS-it të datës 20.05.2017, dhe konstaton se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektim nuk kanë evidentuar çfarëdo çrregullimi në pikën matëse apo furnizim të jashtëligjshëm të ndonjë konsumatori tjetër nga njehsori elektrik nr.1402052290, andaj edhe nuk mund të argumentohet pohimi i konsumatorit.

Bordi i ZRRE thekson se bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe shkresat tjera të lëndës së konsumatorit, konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: **“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”**. Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike, procesverbalit të inspektimit nr.2157783 të datës 20.05.2017, si dhe listave të leximit për periudhën 10/2016 deri në periudhën 03/2017 konstaton se fatura nr.12160DPR-9011299 e datës 26.12.2016, si dhe 01170DPR-9011299 e datës 24.01.2017, paraqesin faturim real mujor te konsumatorit. Andaj Bordi i ZRRE thekson se nuk ka asnjë bazë ligjore apo provë me të cilën mund të konstatohet se faturimi i energjisë elektrike për periudhën dhjetor 2016 dhe janar 2017 nuk është i saktë, dhe me të cilën do të mund të shkarkonte borxhin e kontestuar nga konsumatori.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit I.K.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së